

# **Rregullorja e SHHK “Stublla”**

## **§ 1**

### **Emri, selia, viti financiar**

- Shoqata mban emrin: Shoqata Integruese Humanitare dhe Kulturore “Stublla”.
- Selia e shoqatës është në ... (Zvicër, Itali, Gjermani, Austri)
- Shoqata është e regjistruar në regjistrin e shoqatave.
- Vit financiar është viti kalendarik.

## **§ 2**

### **Qëllimi dhe detyrat**

Themeluesit e kësaj shoqate vijnë nga Stublla e Kosovës dhe shoqatës së tyre i kanë caktuar këto detyra:

#### Integrim

- Përkrahjen e aktiviteteve këmbëse dhe kulturore ndërmjet shqiptarëve dhe vendasve në shtetin ku jetojnë stubllanët
- Përkujdesjen për anëtarët tanë në lëmin e së drejtës për qëndrim, arsimim, punësim dhe pensionim.
- Ndërmjetësimin e kurseve të gjuhëve të huaja për anëtarët tanë ose kurseve të gjuhës shqipe për qytetarët e nacionaliteteve tjera në shtetet ku jetojnë stubllanët.

#### Humanitet

Mjetet e shoqatës mund të përdoren vetëm për qëllime humanitare dhe kryerjen e detyrave të shoqatës. Këtu bëjnë pjesë sipas mundësive financiare të shoqatës:

- Përkrahja financiare për rindërtimin, renovimin, ndërtimin e objekteve të reja shoqërore dhe të infrastrukturës në Stubëll.
- Ndiqma humanitare për banorët nevojtarë në Stubëll dhe rrethinë.

#### Kulturë

- Përkrahjen e projekteve kulturore të shoqatës sonë në shtetin ku jetojnë stubllanët.
- Organizimin e turnirëve sportive, takimeve rinore etj.

## **§ 3**

### **Dobia e përbashkët**

- Shoqata në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa përjashtime ka vetëm qëllime të dobisë së përbashkët.
- Shoqata vepron për qëllime të përbashkëta, ajo nuk ka për qëllim primar rentabilitetin e vet.
- Mjetet e shoqatës mund të përdoren vetëm për qëllime të parapara me rregullore.
- Anëtarët nuk marrin të ardhura nga mjetet e shoqatës.
- Askush nuk guxon të paguhet për shpenzime të cilat janë kryer jashtë qëllimeve të shoqatës apo të (dëm)shpërblehet për harxhime të bëra pa masë.

## **§ 4**

### **Anëtarësia**

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga:

- Anëtarët e rregullt
- Anëtarët përkrahës
- Anëtarët e nderit

Anëtar i rregullt i shoqatës mund të bëhet secili person privat dhe juridik. Lutja për anëtarësim bëhet te kryesia e shoqatës. Kryesia vendos për pranimin e anëtarëve.

Anëtarët përkrahës mund të bëhet gjithashtu secili person privat dhe juridik. Për këtë lloj anëtarësimi gjithashtu duhet të dërgohet një lutje me shkrim te kryesia.

Anëtar nderi mund të bëhet një person, i cili ka bërë të arritura të jashtëzakonshme për shoqatën apo qëllimet e saja. Emërimi për anëtar nderi bëhet nga mbledhja gjenerale sipas propozimit të kryesisë.

## **§ 5**

### **Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve**

Të gjithë anëtarët janë të obliguar që të veprojnë sipas rregullores së shoqatës. Anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet që parashihen si qëllime të shoqatës.

## **§ 6**

### **Pagesa e anëtarësisë**

Pagesa e anëtarësisë duhet të bëhet rregullisht. Shuma e tyre caktohet në mbledhjen gjenerale dhe sipas rregullores së Këshillit të Përgjithshëm të Stubllës (KPS).

## **§ 7**

### **Përfundimi i anëtarësisë**

- Anëtarësia shuhet përmes braktisjes vullnetare, anulimit apo përjashtimit.
- Braktisja vullnetare mund të dorëzohet me shkrim te kryesia deri më 31 dhjetor.
- Kryesia mund të përjashtojë nga anëtarësia, anëtarët të cilët ia dëmtojnë imazhin e shoqatës.
- Anëtarët e anuluar apo të përjashtuar nga kryesia, kanë të drejtë ankese në mbledhjen e rregullt gjenerale që pason.
- Një anëtar mund të përjashtohet edhe në rast kur pas dy vërejtjeve që të kryejë pagesën e anëtarësisë ende nuk e kryen borxhin. Përjashtimi bëhet kur kalojnë më tepër se tre muaj nga dërgimi i vërejtjes së dytë me shkrim.

## **§ 8**

### **Organet e shoqatës**

Organe e shoqatës janë:

- Mbledhja gjenerale
- Kryesia
- Këshilli mbikëqyrës

## § 9

### Mbledhja gjenerale

Organi më i lartë i shoqatës është mbledhja gjenerale dhe ka këto detyra:

- shqyrtimin e raporteve të kryesisë dhe të këshillit mbikëqyrës
- përjashtimin dhe zgjedhjen e kryesisë
- zgjedhjen e këshillit mbikëqyrës
- përcaktimin i pagesës së anëtarësisë
- miratimin e buxhetit
- ndërrimin e rregullores
- aprovimin e propozimeve
- shuarjen e shoqatës.

Mbledhja gjenerale mbahet së paku një herë në vit apo me kërkesën e së paku 1/3 e anëtarëve të rregullt të shoqatës.

- Mbledhja gjenerale thirret me shkrim nga kryesia, paraprakisht në një afat prej 14 ditësh.
- Në thirrjen e mbledhjes gjenerale duhet të figuroj edhe rendi i ditës.
- Propozimet për ndërrimin e rregullores duhet të bëhen publike së bashku me rendin e ditës.
- Mbledhja gjenerale merr vendime pa marrë parasysh numrin prezent të anëtarëve.
- Vendimet dhe zgjedhjet bëhen me shumicë (të thjeshtë) votash.
- Abstenimet nuk llogariten si vota.
- Numri i barabartë i votave llogaritet si refuzim.
- Ndërrimet në rregullore kërkojnë 2/3 e votave valide.
- Votimi bëhet vetëm personalisht dhe nga personat jo të mitur.

## § 10

### Kryesia

Kryesia është përgjegjëse për gjitha detyrat e shoqatës, nëse këto detyra nuk iu janë caktuar ndonjë organi tjetër në bazë të rregullores. Detyrat kryesore të kryesisë janë:

- udhëheqja e punëve aktuale
- përgatitja dhe thirrja e mbledhjes gjenerale si dhe caktimi i rendit të ditës
- zbatimi i vendimeve të mbledhjes gjenerale
- përgatitja e një plani vjetor dhe të buxhetit.
- hartimi i raportit vjetor
- vendimmarrja ndaj kërkesave për pranim dhe përjashtim nga anëtarësia.

Kryesia përbëhet nga (gjithsej 8 anëtarë):

- Kryetari
- zv. Kryetari
- Procesmbajtësi (Zëdhënësi)
- Arkëtari
- zv. Arkëtari
- dhe 3 anëtarë tjerë të kryesisë

Kryesia është vendimmarrëse nëse janë prezent 6 anëtarë të saj. Vendimet e kryesisë merren me shumicë votash. Në rast të numrit të barabartë të votave vendos vota e kryetarit.

Shoqata përfaqësohet në mënyrë zyrtare dhe jozyrtare nga Kryetari, zv. Kryetari dhe Zëdhënësi.

Mandati i kryesisë është dy vjet. Kryesia zgjidhet në mbledhjen gjenerale.

Me përfundimit e anëtarësisë, përfundon edhe detyra e anëtarit të kryesisë.

## **§ 11**

### **Këshilli mbikëqyrës**

Arkëtari shënon në librin e tij hyrjet-daljet dhe jep një raport të shkurtër në çdo mbledhje gjenerale për këto hyrje-dalje. Puna e arkëtarëve kontrollohet në saktësinë e llogaritjeve nga këshilli mbikëqyrës, i cili këshill zgjidhet në mbledhjen gjenerale. Kontrollimi i kasës nuk përfshin edhe qëllimin e shpenzimeve të miratuara nga kryesia.

## **§ 12**

### **Procesverbali**

Rrjedha e mbledhjes gjenerale shënohet në procesverbal. Ky procesverbal duhet të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe nga procesmbajtësi.

## **§ 13**

### **Shuarja e Shoqatës**

Shuarja e shoqatës mund të bëhet vetëm në një mbledhje gjenerale enkas të thirrur për këtë qëllim dhe me një afat prej 4 javësh. Në këtë mbledhje duhet të jenë prezent 4/5 e anëtarëve. Për vendimmarrje janë të nevojshme 3/4 e votave.

## **§ 14**

### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore është aprovua nga mbledhja gjenerale e mbajtur në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_.